# BULETIN

RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

QSP/CPS

Buletin informativ / Nr.30 MARS 2006

PROGRAM I QENDRËS SË STUDIMEVE PARLAMENTARE


## NGA PUNIMET E KUVENDIT

### 20 SHKURT - 10 MARS 2006

**Raportime të institucioneve të pavarura**

**1. Raporti i veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit për vitin 2005 dhe miratimi i projektrezolutës (shqyrtuar në seancë plenare më datë 27.2.2006)**

Raporti i prezantuar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në seancë plenare nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit (KKRT), Halil Lalaj, pasqyron veprimtarinë

*(Vijon në faqen 2)*

## PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT

### 20 MARS - 22 MAJ 2006

1. P/ Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 30.11.2005***

2. P/ Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

*(Vijon në faqen 3)*

## Në këtë numër do të lexoni:


*1. Nga Punimet e Kuvendit për periudhën 20 shkurt - 10 mars 2006* *faqe 1-2*

*2. Programi i Punimeve të Kuvendit për periudhën 20 mars - 22 maj 2006* *faqe 1,3-5*

*2. Kalendari 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 20 mars - 10 prill 2006* *faqe 1, 6-10*


# KALENDARI

## *3 Javor (20 mars - 10 prill 2006) i Punimeve të Kuvendit*

**E Hënë, datë 20.03.2006, ora 17.00**

***-Seancë Plenare***

1. Diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 16.03.2006.
3. Miratimi i Programit të Punës të Kuvendit për periudhën 20 Mars – 22 Maj 2006.
4. Miratimi i Kalendarit 3 javor 20 Mars – 10 Prill 2006, i punimeve të Kuvendit.
5. Miratimi i projekt-rezulotës për vlerësimin e punës të Avokatit të Popullit.
6. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Erion Braçe dhe Alfred Dalipi nga Ministri i Brendshëm.
7. Interpelancë me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, kërkuar nga deputeti Pëllumb Xhufi.

*(Vijon në faqen 6)*

*(Vijon nga faqja 1)*

e këtij institucioni për vitin 2005, e cila është zhvilluar në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe me rekomandimet e Këshillit të Europës. Në raport theksohet se veprimtaria e KKRT-së në fushën e rregullimit të mediave elektronike ka shënuar progres. Gjatë këtij viti është evidentuar rritja e efektivitetit të administratës së institucionit, rritje e qëndrueshmërisë dhe e cilësisë së mjeteve të transmetimit, përmirësim i programacionit dhe nxitje e diversitetit të tij, krijim i hapësirave mediatike për minoritetet, zbatim i rregullave të konkurrencës së ndershme për trajtimin e operatorëve, në bazë të parimeve të barazisë, të proporcionalitetit dhe të mosdiskriminimit.

Gjatë diskutimit rreth raportit, shumica e deputetëve shprehën mendimin se veprimtaria e KKRT-së për rregullimin e veprimtarisë radio e televizive nuk ka qenë në nivelin që përcakton ligji, operatorët radio e televizivë ende nuk e njohin rolin dhe autoritetin e KKRT-së dhe kanë mangësi në respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të të drejtave në zonat e licensuara të mbulimit, KKRT-ja është nënshtruar ndaj presioneve të grupeve të ndryshme të interesit dhe ndaj grupeve të caktuara politike, si dhe nuk ka respektuar të drejtat e transmetimit dhe rregullat e konkurrencës.

Për të vënë në zbatim legjislacionin në fushën e veprimtarive radio e televizive dhe për të rritur rolin e KKRT-së, Kuvendi miratoi një rezolutë, në të cilën kërkon shkarkimin e anëtarëve të KKRT-së, vendosjen e autoritetit të ligjit në mënyrë të plotë dhe reformimin institucional të KKRT-së drejt një institucioni më funksional.

**2. Raporti për veprimtarinë e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave gjatë vitit 2005 dhe miratimi i Projektrezolutës (shqyrtuar në seancë plenare në datat 27 shkurt dhe 1 mars 2006).**

Raporti për veprimtarinë e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (KSHKKP) u paraqit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë e Mjedisin dhe në seancë plenare nga kryetari i këtij Komisioni, Sokrat Sinaj. Në raport pasqyrohet puna e këtij institucioni për hartimin e bazës ligjore, puna e bërë nga komisionet vendore për njohjen dhe kthimin fizik të pronës në të gjitha qarqet, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore, faktorët që kanë ndikuar negativisht në ecurinë e procesit të kthimit e kompensimit të pronave, realizimi i kompensimit financiar në zonën urbane të Tiranës dhe problemet e vërejtura gjatë këtij procesi, shqyrtimi i ankesave të subjekteve të shpronësuara, veprimtaria ekonomike e financiare e institucionit, marrëdhëniet e tij me Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe objektivat për vitin 2006.

Njeri prej anëtarëve të KSHKKP-së, Njazi Kosovrasti, spjegoi votën kundër Raportit të paraqitur nga Kryetari i Komitetit.

Pasi dëgjuan raportin e KSHKKP-së dhe spjegimin e votës kundër tij, deputetët mbajtën dy qëndrime për vlerësimin e punës së këtij institucioni.

Mendimi i shumicës ishte se procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave nga komisionet vendore dhe nga KSHKKP-ja ka filluar me vonesë, kompensimi fizik ende nuk ka filluar, nuk ka një projekt të qartë për përpilimin e hartës së vlerës së pronës dhe nuk është kërkuar zyrtarisht prej KSHKKP-së fondi i nevojshëm për të. Ka ngadalësi në shqyrtimin e ankesave të subjekteve të shpronësuara, vonesat e deritanishme në procedurat për kryerjen e kompensimit fizik dhe financiar rrezikojnë kryerjen brenda afateve ligjore të këtij procesi. Vihen re shkelje ligjore nga disa institucione për tjetërsimin e pronës shtetëtore, duke krijuar diferencime në dhënien e përfitimeve ligjore etj. Duke gjykuar se rezultatet joefektive të punës së KSHKKP-së janë rrjedhojë e mangësive në organizimin e punës dhe e nënvlerësimit të zbatimit të detyrimeve ligjore nga ky institucion, deputetët e shumicës kërkuan rritjen e angazhimit të këtij institucioni për përmbushjen e detyrimeve ligjore, rritjen e rendimentit, të cilësisë së punës dhe të përgjegjësisë nga komisionet vendore, forcimin e rolit mbikëqyrës të KSHKKP-së ndaj komisioneve vendore, zbatimin e ligjit nga institucionet shtetërore për të mënjanuar favoret ndaj disa personave, forcimin e bashkëpunimit të KSHKKP-së me institucionet shtetërore për zbatimin e detyrimeve ligjore, rritjen e bashkëpunimit të këtij institucioni me Kuvendin për të vënë para përgjegjësisë institucionet që nuk përmbushin detyrimet ligjore.

Ata i kërkuan KSHKKP-së të rrisë efektivitetin e punës së tij, të hartojë sa më parë projektin dhe preventivin e hartës së vlerës së pronës, të fillojë pranimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për kompensimin e pronës dhe të përshpejtojë procesin e vendimmarrjes në përgjigje të ankesave të qytetarëve.

Pakica e deputetëve vlerësuan përpjekjet e KSHKKP-së për zbatimin e detyrimeve të tij ligjore dhe tërhoqën vëmendjen e këtij institucioni për moskryerjen brenda afatit të disa detyrimeve, veçanërisht të hartimit të hartës së vlerës së pronës, kërkuan përgatitjen e projektit për përpilimin e hartës së vlerës së pronës, rritjen e bashkëpunimit të KSHKKP-së me institucionet e tjera dhe realizimin brenda afatit e me cilësi të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi një rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së KSHKKP-së, e cila mbështetet në mendimin e shumicës së deputetëve.

# PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT 20 MARS - 22 MAJ 2006

*(Vijon nga faqja 1)*

***Paraqitur nga një grup deputetësh, më 14.11.2005***

3. P/ ligji "Për një trajtim të veçantë" të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira".

**Paraqitur nga një grup deputetësh, më 24.11.2005**

4. P/ ligji 'Për një ndryshim në ligjin nr.7874, datë 17.02.1994 "Për Statusin e Veteranit të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", i ndryshuar.

**Paraqitur nga një grup deputetësh, më15.12.2005**

5. P/ ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.8626, datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 20.12.2005**

6. P/ ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", të ndryshuar.

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më23.12.2005**

7. P/ ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9075, datë 29.5.2003 "Për miratimin e kritereve dhe termave kryesore të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 23.12.2005**

8. P/ ligji "Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 23.12.2005***

9. P/ ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.12.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)" dhe Dekretit nr.1049, datë 27.3.1995, "Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995", të ndryshuar.

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 4.01.2006***

10. P/ ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 4.01.2006***

11. P/ ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 4.01.2006***

12. P/ ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.9314, datë 11.11.2004 "Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 9.01.2006***

13. P/ ligji "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 9.01.2006***

14. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 9.01.2006***

15. P/ ligji "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkolit".

**Paraqitur nga deputetja Lejla Përnaska, më 11.01.2006**

16. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të mallrave (CMR) dhe Protokollin e nënshkrimit".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 18.01.2006***

*(Vijon në faqen 4)*

# PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT 20 MARS - 22 MAJ 2006

*(Vijon nga faqja 3)*

17. P/ ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 18.01.2006***

18. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për transportin e mallrave me rrugë detare, (rregullat e Hamburgut)".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 18.01.2006**

19. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Konfederatës Zviceriane, për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 18.01.2006**

20. P/ ligji "Për faljen e kamatvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, të ndërmarrjeve dhe shoqërive, me kapital tërësisht shtetëror të ujësjellës – kanalizimeve".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 18.01.2006**

21. P/ ligji "Për ratifikimin e Protokollit shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 20.01.2006**

22. P/ ligji "Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjetik".

**Paraqitur nga një grup deputetësh më 26.01.2006**

23. P/ ligji "Për ratifikimin e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 1.02.2006**

24. P/ ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 3.02.2006**

25. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 10.02.2006**

26. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane "Për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar (AGR)".

**Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 10.02.2006**

27. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane "Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në Protokollin e nënshkrimit e në Amendamentin nr.4 të saj".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 10.02.2006***

28. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A për financimin e programit "Menaxhimi i Mbetjeve të ngurta të Tiranës"

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 10.02.2006***

29. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa, S.P.A për financimin e programit "Periferitë Urbane të Tiranës – komponenti infrastrukturor".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 10.02.2006***

30. P/ ligji "Për zbatimin e Konventës "Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe transferimit të minave kundër personit (MKP) dhe për shkatërrimin e tyre".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 10.02.2006***

31. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare shtesë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqë-

***(vijon në faqen 5)***

# PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT 20 MARS - 22 MAJ 2006

*(Vijon nga faqja 4)*

suar nga Ministria e Financave e Fondi i Zhvillimit Shqiptar, si Agjenci e zbatimit të projektit dhe Kreditanstalt FUR WIEDERAUFBAU (KFW) e të marrëveshjes së financimit të projektit "Fondi i Investimeve Sociale- II".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 17.02.2006***

32. P/ ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 25.5.2003 "Për sektorin e Energjisë Elektrike".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 17.02.2006***

33. P/ ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 17.02.2006***

34. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrim tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 17.02.2006***

35. P/ ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.7819, datë 27.04.1994 "Për pronësinë industriale, të ndryshuar".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 17.02.2006***

36. P/ ligji "Për një shtesë në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 17.02.2006***

37. Dekret nr.4778, datë 16.02.2006 "Për kthimin e ligjit nr.9467, datë 30.01.2006 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit nr.4, datë 13.12.2005 të Këshillit të Ministrave "Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën".

38. P/ ligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8419, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

***Paraqitur nga deputeti Nikoll Lesi, më 20.02.2006***

39. P/ ligji "Akti i Lirisë së Shtypit".

**Paraqitur nga deputeti Nikoll Lesi, më 20.02.2006**

40. P/ ligji "Për ratifikimin e një ndryshimi në Protokollin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 23.02.2006***

41. P/ ligji "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9198, datë 1.07.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 20.02.2006***

42. P/ Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 24.02.2006***

43. P/ ligji "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999, "Për standartizimin", të ndryshuar".

***Paraqitur nga Këshilli i Ministrave, më 24.02.2006***

# *KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT*

*(Vijon nga faqja 1)*

**Shqyrtimi i p/ligjeve:**

1. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për shpëtimin, Londër, 28 Prill 1998".

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), për transferimin e personave të dënuar".

3. P/Ligji "Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve".

4. P/Ligji "Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike dhe lundruese të Republikës së Shqipërisë" (për votim).

**Data 21 Mars – 9 Prill 2006: Veprimtari në komisione:**

1. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të mallrave (CMR) dhe Protokollin e nënshkrimit".

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni i Jashtëm***

***- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

2. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Kombeve të Bashkuara "Për transportin e mallrave me rrugë detare (Rregullat e Hamburgut).

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***-Komisioni i Jashtëm***

***-Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Konfederatës Zvicerjane, për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit".

***-Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***-Komisioni i Jashtëm***

***-Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

4. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së shteteve pjesmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij".

***-Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***-Komisioni i Jashtëm***

***-Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

5. P/Ligji "Për ratifikimin e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë".

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni i Jashtëm***

***- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

6. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa, S.P.A. për financimin e programit "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës".

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni i Jashtëm***

***- Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

*(Vijon në faqen 7)*

# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

*(Vijon nga faqja 6)*

7. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa, S.P.A. për financimin e programit "Periferitë Urbane të Tiranës – komponenti infrastrukturor".

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni i Jashtëm***

***- Komisioni i Ekonomisë dhe Fianancës***

8. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane "Për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar (AGR)".

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni i Jashtëm***

***- Komisioni i Integrimit***

***- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

9. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

***- Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

- *Jep mendim:* ***Komisioni për Çështjet Ligjore, Admin. Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

10. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", (grup deputetësh).

***- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

11. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 9314, datë 11.11.2004 "Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë".

***- Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

12. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurencës".

***- Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

13. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 4.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".

***- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

14. P/Ligji "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme".

***- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

***- Jep mendim*: *Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

15. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"".

***- Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

*-Jep mendim:* ***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

16. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9072, datë 25.5.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

***- Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

17. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1995 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

***- Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësinë***

***(Vijon në faqen 8)***

# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

*(Vijon nga faqja 7)*

18. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

***- Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik***

19. P/Ligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8419, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (paraqitur nga deputeti N. Lesi).

***- Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik***

20. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)”, dhe dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995”, të ndryshuar.

***- Komisioni i Ekonomisë dhe Financave***

21. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9198, datë 1.07.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

***- Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë***

22. Shqyrtimi i kërkesës për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (propozuar nga N. Ceka dhe P. Lutaj).

***- Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin***

**23. P/Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”.**

***- Komisioni i Ekonomisë dhe Financës***

**24. Dekret nr. 4806, datë 16.03.2006 “Për kthimin e ligjit nr. 9482, datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.**

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

**25. P/Ligji “Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitik” (grup deputetësh).**

***- Komsioni Përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin***

*-Jep Mendim:* ***Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

26. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa s.p.a. “Për programin e zhvillimit të sektorit privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to”.

***-Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

***- Komisioni i Jashtëm***

***- Komisioni i Ekonomisë dhe Financave***

***- Komisioni i Integrimit***

**SEANCA DËGJIMORE:**

1. Seancë dëgjimore: Për shqyrtimin e Raportit të Këshillit të Ministrave për gjendjen në Shërbimin Civil.

**- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

2. Seancë dëgjimore: Për shqyrtimin e Raportit të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

***- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.***

3. Seancë dëgjimore: Për shqyrtimin e Raportit të Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit.

*(Vijon në faqen 9)*

# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

*(Vijon nga faqja 8)*

***- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.***

4. Seancë dëgjimore: Për shqyrtimin e Raportit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

***- Komisioni për Ekonominë dhe Financat.***

**E Enjte, datë 23.03.2006, ora 10.00**

***-Seancë Plenare***

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces-verbalit të seancës plenare të datës 20.03.2006.
3. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të mallrave (CMR) dhe Protokollin e nënshkrimit".
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Kombeve të Bashkuara "Për transportin e mallrave me rrugë detare (Rregullat e Hamburgut).
5. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Konfederatës Zvicerjane, për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit"
6. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9075, datë 29.5.2003 "Për miratimin e kritereve dhe termave kryesore të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë".
7. P/Ligji "Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit".

***E Hënë, datë 27.03.2006, ora 17.00***

***-Seancë Plenare***

1. Diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces-verbalit të seancës plenare të datës 23.03.2006.
3. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nard Ndoka nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Qemal Minxhozi nga Ministri i Shëndetësisë.
5. Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
6. Miratimi i Projekt-Rezolutës për vlerësimin e punës të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

***E Enjte, datë 30.03.2006, ora 10.00***

***-Seancë Plenare***

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces-verbalit të seancës plenare datë 27.03.2006.
3. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së shteteve pjesmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij".
4. P/Ligji "Për ratifikimin e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë".
5. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa, S.P.A. për financimin e programit "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës".
6. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" (grup deputetësh).
7. Dekret nr. 4806, datë 16.03.2006 "Për kthimin e ligjit nr. 9482, datë 16.02.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
8. P/Ligji "Për një ndryshim, në ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.

***(Vijon në faqen 10)***

# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

*(Vijon nga faqja 9)*

9. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

10. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurencës".

11. Shqyrtimi i kërkesës për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit.

***E Hënë, datë 3.04.2006, ora 17.00***

***-Seancë Plenare***

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proves-verbalit të seancës plenare, datë 30.03.2006.
3. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Leonard Demi nga Ministri i Jashtëm.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Taulant Balla nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.
5. Raport i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
6. Miratimi i Projekt-Rezolutës për vlerësimin e punës të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

***E Enjte, datë 6.04.2006, ora 10.00***

***- Seancë Plenare***

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces-verbalit të seancës plenare të datës 4.04.2006.
3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa, S.P.A. për financimin e programit "Periferitë Urbane të Tiranës – komponenti infrastrukturor".
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane "Për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar (AGR)".
5. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 25.5.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".
6. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
7. P/Ligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8419, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (paraqitur nga deputeti N. Lesi).
8. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve".
9. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa s.p.a. "Për programin e zhvillimit të sektorit privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to".

***E Hënë, datë 10.04.2006, ora 17.00***

***- Seancë Plenare***

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces-verbalit të seancës plenare datë 6.04.2006.
3. Miratimi i Kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 10 – 27 prill 2006.
4. Interpelancë me Ministrin e Brendshëm, kërkuar nga deputeti Petro Koçi.
5. Raport i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

**Denada BRESHANAJ**
Koordinatore Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascpdp.org